

V E N D I M
Nr.397,datë 31.5.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 726, DATË 21.12.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në reshtin e 6-të të pikës 19, pas emërimit “Pedagog me gradë shkencore”, shtohet emërtimi “Kërkues me gradë shkencore”.

2. Në lidhjen 1 “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” bëhen këto ndryshime:

a) Në klasifikimin “A8” shtohen emërtimet “Zëvendëskryetar në Akademinë e Shkencave, Sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave” dhe këto emërtime në klasifikimin “A12” shfuqizohen.

b) Në klasifikimin “B5” shtohet emërtimi “Kërkues me gradë shkencore” dhe në klasifikimin “C2” Shtohet emërtimi “Kërkues”.

3. Në lidhjen II-8 “Niveli i pagës për punonjësit e Akademisë së Shkencave” bëhen këto ndryshime:

a) Numri rendor 2 zëvendësohet me këto emërtime: “Zëvendëskryetar, Sekretar shkencor, klasifikimi “A8”.

b) Numri rendor 3 zëvendësohet me emërtimin “Kërkues me gradë shkencore, klasifikimi “B5””.

c) Shtohet numri rendor 3/1, me emërtimin “Kërkues”, klasifikimi “C2” dhe ky emërtim në numrin rendor 6 shfuqizohet.

d) Në numrin rendor 5 shtesa për funksion bëhet grupi 5.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për Akademinë e Shkencave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta